

14.08.2013

Erdonit Retkoceri



Procesi i anëtarimit në OKB: Dallimet dhe ngjashmëritë e Kosovës dhe
Palestinës

Prishtinë, 2013

Hyrje

Shtetet të cilat deklarojnë pavarësinë e tyre kërkojnë që kjo të jetë ndërkombëtarisht e legjitimuar dhe të jetë e njohur përgjithësisht. Ndonëse njohja e përgjithshme është e ndërlidhur me anëtarimin në Organizatën e Kombëve të Bashkuara, nuk janë te njohur parime të përgjithshme apo parime të ligjit ndërkombëtar të cilat do të konfirmonin këtë mendim.¹ Nëpërmjet këtij shkrimi do të mundohem të sqaroj rrugën drejt atarësimit në OKB për Kosovën dhe Palestinën duke bërë një krahasim të vazhdueshëm ndërmjet tyre. Përderisa po flasim për aderim në një organizatë të caktuar, në këtë rast në OKB, atëherë duhet pasur parasysh konditat e vëna nga organizata në fjalë për ato vende që synojnë anëtarimin. Dhe meqë OKB-ja posedon rregulla të tilla², rrjedhimisht ato do të jenë subjekt i vazhdueshëm i këtij hulumtimi. Por me qëllim që lexuesi të ketë pasqyrë më të qartë të këtij procesi për Kosovën dhe Palestinën, së pari do të njihemi me pozitën e këtyre dy vendëve karshi OKB-së. Palestina nga viti 2012 gëzon statusin e shtetit vezhgues në OKB³ ndërsa Kosova ende nuk ka aplikuar për anëtarim, ndonëse zyrtarë të lartë shtetërorë kanë pohuar se do ta bëjnë këtë së shpejti.⁴ Nëse i referohemi Kartës së OKB-së, gjegjësisht artikullit 4 ku deklarohet se: “Anëtaria për në Organizatën e Kombëve të Bashkuara është e hapur për të gjitha shtetet tjera paqedashëse,” atëhere shtrohet pyetja se a gëzojnë shtetësi Kosova dhe Palestina, dhe se a janë me të vërtetë shtete paqedashëse?

Elementët e shtetësisë dhe roli i saj në anëtarimin në OKB

Për të dëshmuar ekzistencën e shtetësisë duhet të plotësohen elementët si: një popullatë permanente, një hapësirë territoriale e definuar, një qeveri dhe kapacitet për të hyrë në marrëdhënie diplomatike me shtete tjera.⁵ Këto elemente padyshim mund të gjenden edhe në

¹ Martin Wählisch, “*Beyond a Seat in the United Nations: Palestine’s U.N Membership and International Law*”, (Përtej një ulëse në Kombët e Bashkuara: Anëtaria e Palestinës në OKB dhe ligji ndërkombëtar), f. 232, Volumi 53, 2012 http://www.harvardilj.org/wp-content/uploads/2012/06/HILJ-Online_53_Wahlisch.pdf

² Karta e Kombëve të Bashkuara, Kapitulli II: “Anëtaria”, 1945, San Francisco.

³ Rezoluta A/67/L.28 Për ngritjen e statusit të Palestinës në shtet vezhues jo anëtar <http://daccess-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/LTD/N12/607/36/PDF/N1260736.pdf?OpenElement>

⁴ Deklarata e Ministrit të punëve të jashtme Enver Hoxhaj Publikuar: 19.12.2012 Marrë: 06.07.2013 <http://www.hurriyetdailynews.com/Default.aspx?pageID=238&nid=37172>

⁵ Për më shumë rreth elementëve të shtetësisë shiko:

Konventa e Montevideos mbi të Drejtat dhe Detyrat e Shtetëve, Artikulli 1, 1933, Montevideo; Max Weber, “*Politik als Beruf*” (Politika si profesion), Asdreni, 2006, Shkup.

rastin e Kosovës dhe Palestinës, edhe nëse ka ngecje në ndonjëren pikë prej tyre. Por meqë Asambleja e Përgjithshme e OKB-së ka miratuar rezolutë me të cilën e njeh shtetësinë e Palestinës⁶, atëherë kjo do të duhej të paraqiste një çështje të kryer për këtë shtet meqë kësajsoj themelohet Autoriteti Palestinez dhe numër i madh shtetësh më pas e njohën shtetësinë e saj⁷, përkundër Kosovës, së cilës i mungon një rezolutë e tillë me çka i sigurohet shtetësia. Megjithatë, meqë Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë më kërkesë të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së ka dhënë mendimin e saj këshillues në lidhje me shpalljen unilaterale të pavarësisë së Kosovës duke u deklaruar në favor të pavarësisë së saj, atëherë kjo mund të merret si dëshmi në rastet kur vihet në pyetje shtetësia e Kosovës vis-à-vis ligjeve ndërkombëtare.⁸ Por duhet pasur parasysh se për shtetet e reja ngecja në ndonjë aspekt nuk duhet marr si dëshmi të mungesës kruciale të shtetësisë meqë “shtetësia nuk është e lindur por e zhvilluar”⁹, në disa raste kërkon kohë më shumë për konsolidimin e saj se në raste tjera. Pranimi i shtetësisë nuk është kusht i pashmangshëm për anëtarim në OKB përderisa ka raste të shtetëve anëtare që nuk njihen nga një numër shtetësh tjera poashtu anëtare të OKB-së¹⁰, por kjo nuk paraqet problem që ata të vazhdojnë veprimtarinë e tyre si shtete anëtare të kësaj organizate.

Shtete paqedashëse

Element tjetër me rëndësi të veçant për shtetet që synojnë një ulëse në OKB është që vendi të dëshmoj se ka qëllime paqësore.¹¹ Palestina ndaj Kosovës ka vështirësi më të mëdha për të bindur vendet tjera se është shtet paqedashës meqë vazhdimisht merr akuza të padrejta për veprimtari terroriste. Por në anën tjetër, anëtar të Kombëve të Bashkuara konsiderojnë se meqë Palestina është kthyer nga ligjet ndërkombëtare dhe OKB-ja për të realizuar të drejtën e saj

⁶ Rezoluta A/RES/43/177 The question of Palestine, Çështja e Palestinës

http://www.un.org/ga/search/view_doc.asp?symbol=A/RES/43/177&Lang=E&Area=RESOLUTION

⁷ David Makovsky, *The Palestinian Bid for UN Membership: Rationale, Response, Repercussions* (Oferta Palestineze për anëtarim në OKB: arsyeshmëri, përgjigje, vazhdim), The Washington Institute for Near East Policy, f. 2, Numri i 7, 2011.

⁸ Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, Pajtueshmëria me ligjin ndërkombëtar i shpalljes unilaterale të pavarësisë me respekt ndaj Kosovës, Mendimi Këshilldhënës, 2010, Hagë.

⁹ Martin Wählisch, “*Beyond a Seat in the United Nations: Palestine’s U.N Membership and International Law*”, (Përtej një ulëse në Kombët e Bashkuara: Anëtarësia e Palestinës në OKB dhe ligji ndërkombëtar), f. 259, Volumi 53, 2012 http://www.harvardilj.org/wp-content/uploads/2012/06/HILJ-Online_53_Wahlisch.pdf

¹⁰ Shtetësia e Izraelit nuk njihet nga 33 shtete të ndryshme, ndër të cilat janë edhe shumica e shtetëve arabe, Tuqia refuzon shtetësinë e Qirpos, ndonëse dyjat janë pjesë e OKB-së si shtete me të drejta të plota Ibid. 232.

¹¹ Karta e Kombëve të Bashkuara, Kapitulli II: Anëtarësia, Artikulli IV, 1945, San Francisco.

legjitime për vetëvendosje, ajo kështu ka dëshmuar lartë se është një shtet paqëndashës.¹² Ndërsa në rastin e Kosovës vërehet një kujdes i shtuar në aspektin e formimit të një shteti paqëndashës meqë në preambulën e Kushtetutës së këtij vendi deklarohet mjaft qartë një gjë e tillë.¹³ Një tjetër dëshmi për qëndrimet paqëndashëse të Kosovës është edhe Indeksi Global i Paqës i cili e rendit Kosovën në vendin e 72-të, para SHBA-ve që renditen në vendin e 99-të dhe afër Francës e cila renditet e 53-ta¹⁴ si shtete që janë paqëndashëse. U munduam të dëshmojmë se si Kosova, ashtu edhe Palestina përbëjnë kriterët e parapara në artikullin 4 të Kartës së OKB-së, të qenurit shtet dhe paqëndashës me qëllim që anëtarësi në OKB të jetë i mundshëm. Gjithsesi duhet pasur parasysh se ata që e vlerësojnë përfundimisht ekzistencën e shtetësisë së aplikuesve dhe qëllimet e tyre, se a janë paqëndashëse apo jo, janë Këshilli i Sigurimit i pasuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombëve të Bashkuara.¹⁵ Kështu arrijmë para çështjes më të rëndësishme gjatë procesit të aplikimit në OKB, arritja e përkrahjes së Këshillit të Sigurimit dhe Asamblesë së Përgjithshme që të votojnë në favor të kërkesës së tyre për aplikim.

Procedura e aplikimit dhe sfidat pasuese

Në procesin e aplikimit parashihet që shteti që aspiron anëtarësimin në OKB dorëzon kërkesën për anëtarësim te sekretari i përgjithshëm, i cili më pas dërgon kopjen e kërkesës drejt Këshillit të Sigurimit. Këshilli i Sigurimit më pas voton kërkesën dhe për të kaluar kjo kërkesë duhet të sigurohen 9 vota prej 15 gjithsej sa ka anëtar Këshilli i Sigurimit, me kusht që asnjë anëtar i përhershëm me të drejtën e vetos¹⁶ mos të votojë kundër saj. Nëse kalon kërkesa atëherë Këshilli i Sigurimit rekomandon aplikacionin drejt Asamblesë së Përgjithshme, e cila me 2/3 e votave të anëtarëve prezent në mbledhje dhe që votojnë, e miraton aplikacionin për anëtarësim të shtetit të ri.¹⁷ Dilema si për Kosovën ashtu edhe për Palestinën qëndron pikërisht në faktin se anëtarësimi i tyre rrëzohet nga shtetet me të drejtën e vetos brenda Këshillit të Sigurimit. Pasiqë Shtetet e

¹² Deklarata e ambasadores braziliane Maria Luiza Ribeiro Viotti në debatin e hapur të Këshillit të Sigurimit, 24.10.2011 <http://www.un.int/brazil/speech/11d-mlrv-The-Situation-in-the-middleeast.html>

¹³ Kushtetuta e Kosovës, preambula.

¹⁴ <http://www.visionofhumanity.org/#page/indexes/global-peace-index/2013/KSV/OVER>

¹⁵ Martin Wählisch, "Beyond a Seat in the United Nations: Palestine's U.N Membership and International Law" (Përtej një ulëse në Kombët e Bashkuara: Anëtarësia e Palestinës në OKB dhe ligji ndërkombëtar)", f. 240, Volumi 53, 2012 http://www.harvardilj.org/wp-content/uploads/2012/06/HILJ-Online_53_Wahlisch.pdf

¹⁶ Anëtarë të përhershëm janë: Britania e Madhe, Franca, Kina, Rusia dhe SHBA-të. Karta e Kombëve të Bashkuara, Kapitulli V: Votimi, Artikulli 27.3, 1945, San Francisco.

¹⁷ http://www.un.org/News/dh/infocus/UN_membership.shtml

Bashkuara të Amerikës kërcënojnë me veto kërkesën e palestinezëve për anëtarim,¹⁸ atëherë edhe anëtarimi i Palestinës nën kushtet e tanishme është e pamundur, sidomos nëse merret parasysh fakti se SHBA-të janë fuqia e kohës.¹⁹ Një situatë të ngjashme mund të përjeton edhe Kosova, meqë Rusia është zotuar të bllokoj një kërkesë të mundshme për anëtarim nga ana kosovare.²⁰ Kjo nënkupton se edhe Kosova për momentin e ka të pamundur të arrijë OKB-në, dhe për të bërë situatën edhe më të vështirë, pasojnë edhe kërcënimet nga shteti kinez për të përdorë veton ndaj Kosovës.²¹ Përderisa Serbia ka synim BE-në, atëherë Brukseli zyrtar mund të kushtëzojë Beogradin me statusin e shtetit vëzhgues jo anëtar për Kosovën duke ia hapur Serbisë rrugën edhe më tej drejt BE-së,²² ndonëse kjo nuk do të ishte zgjidhje e plotë e problemit për Kosovën. Në rastin e Palestinës kjo mund të jetë shumë më e lehtë, përderisa praktika e punës së OKB-së në rastin e pranimit të Izraelit ku një premtim për të qenë shtet paqëndrues në kombinim me një marrëveshje armëpushimi edhe pa nënshkruar marrëveshje përfundimtare mes Izraelit dhe Palestinës ka qenë e mjaftueshme, atëherë kjo paraqet një precedent edhe për rastin e Palestinës e përfshirë në këtë rast.²³

Përfundimisht Kosova dhe Palestina do kenë vështirësi të mëdha për të arritur statusin e anëtarit me të drejta të plota, jo se u mungojnë shtetësia apo qëllimet paqësore, por për shkak të fuqisë shumë të madhe që gëzojnë shtetet e përhershme të OKB-së nëpërmjet të drejtës së vetos. Nuk duhet harruar se edhe nëse këto 2 vende do të plotësonin kriterët për tu pranuar në OKB, shtetet

¹⁸ Martin Wählisch, "Palestine's UN membership and International Law" (Anëtarësia e Palestinës në OKB dhe ligji ndërkombëtar), 2011 Publikuar: 22.07.2011 Marrë: 02.08.2013
http://72.29.89.109/~palchron/old/view_article_details.php?id=16998

David Makovsky, "The Palestinian Bid for UN Membership: Rationale, Response, Repercussions" (Oferta Palestineze për anëtarim në OKB: arsyeshmëri, përgjigje, vazhdim), The Washington Institute for Near East Policy, f. 1, Numri i 7, 2011.

¹⁹ Ting Way, "EU-China Relations: Economic, Political and Social Aspects" (Raportet BE-Kinë: Aspektet ekonomike, politike dhe sociale), Hong Kong.

²⁰ Kosovo profile

<http://www.bbc.co.uk/news/world-europe-18328859> publikuar: 28.06.2013 marrë: 15.08.2013

²¹ Fears of global separatism after UN court rules Kosovo's independence declaration legal

<http://www.foxnews.com/world/2010/07/23/fears-global-separatism-court-rules-kosovos-independence-declaration-legal/> publikuar 23.07.2010 marrë: 15.08.2013

²² Kosovës statusi i vëzhguesit në OKB?!

<http://www.koha.net/?page=1,13,150919> publikuar: 02.07.2013 marrë: 15.08.2013

²³ Martin Wählisch, "Beyond a Seat in the United Nations: Palestine's U.N Membership and International Law" (Përtej një ulëse në Kombët e Bashkuara: Anëtarësia e Palestinës në OKB dhe ligji ndërkombëtar), f. 240, Volumi 53, 2012 http://www.harvardilj.org/wp-content/uploads/2012/06/HILJ-Online_53_Wahlisch.pdf

si SHBA-të apo fuqitë evropiane kanë shkelur rregullat ndërkombëtare në interes të tyre²⁴ andaj ka gjasa që të bllokohet anëtarësia e tyre. Nga kjo do të përfitonin palët e treta që në këtë rast do të ishin Izraeli mbi Palestinën dhe Serbia mbi Kosovën. Sido që të jetë, kam shpresë së statusi i anëtarit me të drejta të plota nuk do të jetë larg për këto dy vende.

Literatura:

- Karta e Kombëve të Bashkuara, 1945, San Francisco.
- Martin Wählisch, “*Beyond a Seat in the United Nations: Palestine’s U.N Membership and International law*” (Përtej një ulëse në Kombët e Bashkuara: Anëtarësia e Palestinës në OKB dhe ligji ndërkombëtar), Volumi 53, 2012.
- Muhsin Muhammed Salih, Çështja palestineze – historia dhe zhvillimi i saj deri në 2005, Jehona study center, Tiranë, 2006.
- David Makovsky, “*The Palestinian Bid for UN Membership: Rationale, Response, Repercussions*” (Oferta Palestineze për anëtarim në OKB: arsyeshmëri, përgjigje, vazhdim), The Washington Institute for Near East Policy, Numri i 7, 2011.
- Max Weber, “*Politik als Beruf*” (Politika si profesion), 2006, Asdreni, Shkup.
- Francis Fukuyama, “*State building*” (Shtet ndërtimi), Cornell University Press, 2004, New York.
- International Crisis Group, *Serbia and Kosovo: The Path to Normalization* (Serbia dhe Kosova: Rruga drejt normalizimit), Brussels, 2013.
[http://www.crisisgroup.org/~media/Files/europe/balkans/kosovo/223-serbia-and-kosovo-the-path-to-normalisation.pdf](http://www.crisisgroup.org/~/media/Files/europe/balkans/kosovo/223-serbia-and-kosovo-the-path-to-normalisation.pdf)
- Xenia Dimoka, Topic B: The question of the admission of Kosovo to the United Nations, Anatolia College, 2012.
<http://www.acmun.gr/documents/guides/GA5%20The%20question%20of%20the%20admission%20of%20Kosovo%20to%20the%20United%20Nations.pdf>
- Sevil Küçükkoşum, publikuar: 19.12.2012, marr 06.07.2013
<http://www.hurriyetdailynews.com/Default.aspx?pageID=238&nid=37172>
- <http://www.visionofhumanity.org/#page/indexes/global-peace-index/2013/KSV/OVER>
- Rezolutat A/67/L.28 dhe A/RES/43/177, deklarata të ambasadorëve në OKB.

²⁴ Francis Fukuyama, “*State building*” (Shtet ndërtimi), f. 107, Cornell University Press, 2004, New York.

- <http://www.bbc.co.uk/news/world-europe-18328859>
- Ting Way, “*EU-China Relations: Economic, Political and Social Aspects*” (Raportet BE-Kinë: Aspektet ekonomike, politike dhe sociale), Hong Kong.